

ABSTRAKTI

Objekti i këtij punimi të masterit është aktgjykimi lirues, kurse objektivi i tij është për të treguar rëndësinë që ka aktgjykimi lirues pas një procesi të hulumtimit profesional të bazuar në ligj dhe prova që e drejtojnë shpalljen e tij si dhe për shkak të peshës juridike që përmban poashtu dhe efekteve të cilat i krijon në shoqëri.

Qëllim kryesor i këtij punimi është që të analizojë, interpretojë dhe vlerësoj aktgjykimet liruese të Gjykatës Themelore të Ferizajt gjatë viteve 2019-2023.

Arsyet që kanë determinuar trajtimin e aktgjykimit lirues janë:

1. Mungesa e punimeve gjithpërfshirëse lidhur me aktgjykimin lirues;
2. Analiza e zgjidhjeve ligjore për të nxjerrë në dritë përparësitë dhe mangësitë eventuale që ato mund të kenë dhe
3. Dhënia e rekomandimeve përkatëse për gjykatat kur vendimarrja e tyre ndërlidhet me shqiptim të aktgjykimeve liruese.

Kjo determinohet nga fakti sepse përmes aktgjykimeve liruese sigurohet që vendimet gjyqësore të ndjekin një linjë të qëndrueshme ligjore dhe të respektojnë precedentin ligjor të veçantë për një çështje të caktuar, se aktgjykimi lirues ndihmon në sigurimin e konsistencës dhe në forcimin e sundimit të ligjit dhe në promovimin e drejtësisë së barabartë për të gjithë, dhe se roli i tyre është i rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të individëve. Duke qenë se ne jemi shtet demokratik në tranzicion me qëllim të krijimit të institucioneve stabile arsya tjetër pse kam zgjedh trajtimin e aktgjykimit lirues është roli i tij në forcimin e demokracisë duke rrit transparencën e institucioneve e cila poashtu rrit besimin e publikut në qeverisjen e tyre dhe në sundimin e ligjit.